



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.65

8 qershor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9746 datë 31.5.2007	Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 25.5.2007 të Këshillit të Ministrave “Për lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të disa njësive të Forcave Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në kuadër të operacionit të masave të sigurisë për vizitën e Presidentit Amerikan në Shqipëri	1755
Vendim i Kuvendit nr.103, datë 31.5.2007	Për krijimin e Komisionit për Integrimin në NATO	1755
Rezolutë e Kuvendit datë 28.5.2007	Për vlerësimin e Punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2006	1756
Vendim i KM nr.306, datë 25.5.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Stravaj”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë ...	1757
Vendim i KM nr.307, datë 25.5.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Sllabinjë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë...	1758
Vendim i KM nr.308, datë 25.5.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Rapuni 1”, “Rapuni 2” e “Rapuni 3”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1758
Vendim i KM nr.317, datë 30.5.2007	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të shtëpisë së pushimit, të Ministrisë së Brendshme, Durrës	1759

Vendim i KM nr.323, datë 30.5.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”.....	1761
Vendim i KM nr.324, datë 30.5.2007	Për dhënien në përdorim Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të disa mjediseve të ndërtesës (Godinës) “Ish-INIMA”	1761
Udhëzim i KM nr.3, datë 16.5.2007	Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara	1763
Udhëzim i MF nr.8, datë 5.6.2007	Për një ndryshim në udhëzimin nr.3, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”	1765
Urdhër i MB nr.756, datë 17.5.2007	Për delegim kompetence	1768
Kërkesë e AKKP	Për kompensim të menjëhershëm të trojeve të shtetasve Bardhyl Pelingu dhe trashëgimtarëve të Refik Toptanit	1769

LIGJ
Nr.9746, datë 31.5.2007

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT NR.1, DATË 25.5.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LEJIMIN E HYRJES NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË DISA NJËSIVE TË FORCAVE USHTARAKE TË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS, NË KUADËR TË OPERACIONIT TË MASAVE TË SIGURISË PËR VIZITËN E PRESIDENTIT AMERIKAN NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 25.5.2007 të Këshillit të Ministrave “Për lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të disa njësive të Forcave Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në kuadër të operacionit të masave të sigurisë për vizitën e Presidentit Amerikan në Shqipëri”.

Shpallur me dekretin nr.5341, datë 4.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.103, datë 31.5.2007

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PËR INTEGRIMIN NË NATO

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Integrimin në NATO.
- II. Komisioni ka për detyrë:
 1. Nxitjen dhe promovimin e procesit të integrimit të Shqipërisë në NATO.
 2. Koordinimin e politikave të Kuvendit me Këshillin e Ministrave dhe institucionet e tjera, lidhur me integrimin në NATO.
 3. Bashkërendimin ndërparlamentar të komisioneve të përhershme të Kuvendit për synimet e këtij Komisioni.
 4. Përgatitjen, shqyrtimin dhe/ose promovimin e amendamenteve të nevojshme të kuadrit ligjor për arritjen e standardeve për integrimin në NATO.
 5. Forcimin e bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Asamblesë Parlamentare të NATO-s, për të ndikuar në nxitjen e procesit të integrimit të Shqipërisë në NATO.
 6. Forcimin e bashkëpunimit me parlamentet e rajonit, shkëmbimin e përvojave në procesin e integrimit në NATO.

7. Transparencën ndaj opinionit publik, si dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile në zbatimin e procesit të integritetit në NATO.

8. Organizimin e rregullt të debateve parlamentare, me qëllim mbajtjen e këtij problemi vazhdimisht në agjendat politike kombëtare.

III. Komisioni përbëhet nga 10 anëtarë (5 nga shumica dhe 5 nga opozita parlamentare).

IV. Komisioni i Posaçëm Parlamentar drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Demokratike dhe një nga Partia Socialiste.

V. Afati i veprimtarisë së Komisionit përcaktohet në përputhje me zhvillimet dhe nevojat e proceseve të lartpërmendura.

VI. Vendimet në Komision merren me shumicën e votave.

VII. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

1. Ferdinand Xhaferri - Bashkëkryetar

2. Pandeli Majko - Bashkëkryetar

3. Marko Bello - anëtar

4. Arjan Starova - anëtar

5. Sabit Brokaj - anëtar

6. Arenca Trashani - anëtare

7. Gëzim Musabelliu - anëtar

8. Aldo Bumçi - anëtar

9. Arben Malaj - anëtar

10. Genc Sharku - anëtar

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2006

Kuvendi i Shqipërisë,

- njeh rëndësinë e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në bazë të Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor, si institucioni që merret me përgatitjen, mbikëqyrjen, kontrollin dhe verifikimin e procesit zgjedhor;

- përkrah dhe mbështet rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për kontributin e këtij institucioni në arritjen e standardeve për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

Konstaton se:

- raporti vjetor i paraqitur nga KQZ-ja për punën e kryer nga ky institucion gjatë vitit 2006 është në përputhje me kërkesat dhe detyrimet ligjore, si dhe i pandikuar nga politika;

- KQZ-ja ka kryer detyrën e saj ligjore në mënyrë që procesi zgjedhor i pjesshëm për organet e qeverisjes vendore në komunën Fajza gjatë vitit 2006 të administrohen në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor;

- ka përdorur me efikasitet fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit për procesin zgjedhor, duke ulur koston e administrimit të votimit për çdo zgjedhës;

- me gjithë presionin e subjekteve të veçanta zgjedhore, KQZ-ja ka kryer në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2006 një volum pune të konsiderueshëm për miratimin e akteve nënligjore, të dokumentacionit dhe logjistikës përkatëse për fazën përgatitore të zgjedhjeve vendore;

- për shkak të presionit politik të disa subjekteve zgjedhore, KQZ-ja nuk ka mundur të përmbushë të gjitha detyrimet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor për përgatitjen e zgjedhjeve vendore të vitit 2007;

- është përpjekur të vendosë marrëdhënie të mira dhe të bashkëpunojë në mënyrë të vijueshme me institucionet shtetërore, partitë politike, institucionet ndërkombëtare dhe median.

Kuvendi kërkon që për vitin 2007 t'u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

- zbatimin rigoroz të Kushtetutës dhe të legjislacionit zgjedhor në të gjithë veprimtarinë e këtij

institucioni;

- respektimit të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë që mbikëqyrin procesin zgjedhor për arritjen e standardeve më të përparuara, si kusht parësor për integrimin euroatlantik të vendit tonë;

- identifikimit të problemeve të menaxhimit të procesit zgjedhor, që vijnë si pasojë e boshllëqeve ose zgjidhjeve ligjore;

- rritjes së performancës, trajnimit dhe aftësimit të vijueshëm profesional të administratës zgjedhore qendrore e vendore;

- krijimit të një klime të përshtatshme bashkëpunimi për zhvillimin e një procesi zgjedhor të lirë, të drejtë e të ligjshëm;

- edukimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve në vijimësi për ushtrimin e së drejtës së tyre kushtetuese, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet demokratike.

28 maj 2007

VENDIM
Nr.306, datë 25.5.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “STRAVAJ”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Stravaj” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 9.5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “FAVINA 1” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.307, datë 25.5.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SLLABINJË”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Sllabinjë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit, prej 8 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “LNK” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.308, datë 25.5.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “RAPUNI 1”, “RAPUNI 2” E “RAPUNI 3”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Rapuni 1”, “Rapuni 2” e “Rapuni 3” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit, prej 9.5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “C&S CONSTRUCTION” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.317, datë 30.5.2007

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SHTËPISË SË PUSHIMIT, TË MINISTRISË SË BRENDSHME, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet “Specialist”, “Përgjegjës sektori” dhe “Drejtor”, në Shtëpinë e Pushimit, të Ministrisë së Brendshme, Durrës, janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 1), e lidhjes nr.1-diplomë e shkollës së lartë, është 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) e lidhjes nr.1, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3), e lidhjes nr.1, është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4, e lidhjes nr.1.

6. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tjerë të Shtëpisë së Pushimit, të Ministrisë së Brendshme, Durrës, të cilët nuk përmenden në lidhjen nr.1, janë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Për punonjësit, që paguhen sipas lidhjes nr.2, shtesa për vjetërsi pune jepet në masën 1 për qind, pas çdo viti pune, por jo më shumë se për 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën bazë mujore.

8. Shtesa për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, për punonjësit, që paguhen sipas lidhjes nr.2, zbatohet sipas shkallëve dhe rregullave, të përcaktuara në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar. Këto shtesa llogariten mbi pagën bazë mujore të klasës VI të lidhjes II/M të vendimit të sipërpërmendur.

9. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

10. Efektet financiare, për vitin 2007, të përballohen nga fondet e planifikuara për Ministrinë e Brendshme, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006, “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR POZICIONET “SPECIALIST”, “PËRGJEGJËS SEKTORI” DHE “DREJTOR”, NË SHTËPINË E PUSHIMIT TË MINISTRISË SË BRENDSHME, DURRËS

EMËRTIMI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit	Shtesa vjetore	Shtesa për	Shtesa për pozicion

		(PG) lekë	për vjetërsi (SHV) përqindje	kualifikim (SHK) lekë	(SHP) lekë
Drejtor	III-a	10.050	2%	0	59.714
Përgjegjës sektori	IV-a	10.050	2%	0	32.571
Specialist	IV-b	10.050	2%	0	21.714

LIDHJA NR. 2

Nr.	Pozicioni	Paga bazë mujore (lekë)	Shtesë për kushte pune (lekë/muaj)
1.	Përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe i restorantit)	35.000	5.000
2.	Përgjegjës (gjelbërimi, aktivitete të tjera ndihmëse)	28.000	
3.	Kuzhinier	21.850	5.000
4.	Banakier	21.850	
5.	Administrues hoteli	21.850	5.000
6.	Ndihmëskuzhinier	19.550	3.000
7.	Llogaritar Kamerier Receptionist Mekanik Shofer i titullarit Magazininier	17.250	
8.	Elektricitist Hidraulik	17.250	3.000
9.	Marangoz Bojaxhi	17.250	2.000
10.	Punëtor (hoteli) Punëtor (gjelbërimi)	16.100	
11.	Punëtor (kuzhine) Punëtor (restoranti)	14.950	
12.	Punëtor (lavanteri)	14.300	

VENDIM
Nr.323, datë 30.5.2007

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.78, DATË 8.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E MATURËS SHTETËRORE DHE PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA PUBLIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9 e vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Efektet financiare:

9.1 për provimet e detyruara, të Maturës Shtetërore, të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;

9.2 për provimet me zgjedhje, të Maturës Shtetërore, të përballohen nga një tarifë e vetme për çdo nxënës/aplikant, prej 2000 lekësh në vit.

9.2.1 Nxënësi/aplikanti një kopje të mandatarkëtimit të pagesës së tarifës së mësipërme e dorëzon së bashku me formularin A2 të aplikimit, i cili shërben për krijimin e bazës së të dhënave, të kërkesave të maturantëve për degët, ku duan të konkurrojnë për studime universitare.

9.2.2 Tarifa e provimeve të Maturës Shtetërore arkëtohet nëpërmjet sistemit të bankave të nivelit të dytë ose zyra të postës shqiptare, në adresë të Degës së Thesarit, Tiranë, për Agjencinë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve.

9.2.3 Administrimi i të ardhurave nga tarifa e provimeve me zgjedhje, të Maturës Shtetërore, realizohet nga Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve dhe të ardhurat e siguruar nga kjo tarifë derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

9.3 për pranimet e kërkesave për studim në shkollat e larta publike të mbulohen nga buxheti i shkollave të larta dhe nga tarifa përkatëse, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.324, datë 30.5.2007

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS TË DISA MJEDISEVE TË NDËRTESES (GODINËS) “ISH-INIMA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:



1. Dhënie në përdorim Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) “Ish-INIMA”, kati përdhe, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes së përcaktuar në planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN DE L'ÉTAGE 100



UDHËZIM
Nr.3, datë 16.5.2007

PËR PROCEDURAT E DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE, TË PANDARA

Në mbështetje të neneve 100 e 102 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, dhe të pikës 4 të vendimit nr.531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave “Për tokat bujqësore të pandara”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

I. Krijimi dhe përbërja e bordit të dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara (më poshtë BQTBP)

1. Në çdo komunë dhe/ose bashki, të cilat kanë në administrim toka bujqësore, të pandara, të krijohet BQTBP-ja.

2. BQTBP-ja ka këtë përbërje:

- kryetarin e komunës dhe/ose bashkisë kryetar të bordit;
- një përfaqësues të drejtorisë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit anëtar;
- një përfaqësues të sektorit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në qark anëtar;
- specialistin e urbanistikës së komunës dhe/ose bashkisë anëtar;
- specialistin e zyrës së menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT), në komunë dhe/ose bashki sekretar.

3. BQTBP-ja ka për detyrë dhe mban përgjegjësi për:

a) ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, të ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” dhe të akteve nënligjore, në zbatim të tij;

b) informimin, në mënyrë të përhershme, për ekzistencën e resurseve të tokave bujqësore, të pandara;

c) garantimin e një konkurrence, të lirë dhe të barabartë, ndërmjet pjesëmarrësve të ankandit të dhënies me qira të tokës;

ç) përcaktimin e fituesit të ankandit të dhënies me qira të tokës bujqësore;

d) verifikimin e respektimit të kushteve, të përcaktuara nga palët në kontratë.

II. Procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara

1. Tokat bujqësore të pandara u jepen me qira personave fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, për t’u përdorur e shfrytëzuar për veprimtari bujqësore dhe blegtorale.

2. Kur për të njëjtën sipërfaqe toke paraqiten dy ose më shumë kërkesa për marrje me qira, përfituesi përcaktohet me ankand.

3. Kur për një sipërfaqe të caktuar paraqitet vetëm një kërkesë, BQTBP-ja në komunë dhe/ose bashki, shpall, në qendër të komunës dhe/ose bashkisë, njoftimin për dhënien me qira.

4. Njoftimi përmban qëllimin e dhënies me qira të tokës për (pemëtoje, vresht, ullishtë, bimë arrash, serra etj.), sipërfaqen, vendin e paraqitjes së dokumenteve, afatin përfundimtar të paraqitjes së ofertave.

Vendi, data dhe ora e zhvillimit të ankandit vendosen nga kryetari i bordit, në bashkërendim me përfaqësuesin e drejtorisë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit dhe përfaqësuesin e seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në qark.

Njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe, nëse është e mundur, edhe në mediat vendore. Njoftimi shpallet dhe në mjediset e njësisë së qeverisjes vendore.

5. Periudha nga data e njoftimit deri në datën e zhvillimit të ankandit është 15 ditë. Kur data e zhvillimit të ankandit bie në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, ankandi zhvillohet në ditën e parë të punës pas pushimit.

6. Konkurruesit për marrjen me qira të tokës bujqësore i paraqesin ofertat deri në dy ditë para datës së zhvillimit të ankandit. Oferta paraqitet në zarf të mbyllur dhe përmban:

a) Një kërkesë me shkrim për marrjen me qira;

b) Formularin tip, të plotësuar me të dhënat e përgjithshme të personit fizik ose juridik, të interesuar;

c) një plan biznesi për tokën, që kërkohet me qira, të shoqëruar me një shpjegim të hollësishëm për programin e investimit, llojin e teknologjisë dhe/ose të farërave dhe fidanëve, që do të përdoren, impaktin e projektit në punësim dhe në zhvillimin e zonës dhe të dhëna për aftësitë, financiare dhe menaxheriale, të të interesuarit.

Zarfi me ofertën i dorëzohet sekretarit.

7. BQTBP-ja mblidhet, me pjesëmarrje të plotë të anëtarëve, në datën dhe orën e caktuar në njoftim. Veç anëtarëve të bordit, në hapjen e ofertave marrin pjesë edhe ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre, të pajisur me prokurë dhe dokumente identifikimi.

8. Oferta, që garanton perspektivë më të mirë zhvillimi, vlerësohet me përparësi nga bordi. Kur rezultojnë dy ose më shumë oferta me të njëjtën shumë pikësh, përsa i përket planit të zhvillimit, bordi vlerëson si fituese ofertën, që jep çmimin më të lartë të qirasë.

Çmimi dysHEME i dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara, me të cilin fillon ankandi, nuk mund të jetë më i ulët se 6 000 (gashtë) mijë lekë/ha, në një vit kalendarik.

Në raste të veçanta, kur sipërfaqet e kërkuara për qiradhënie janë mbi 10 ha dhe në planbiznesin e paraqitur parashikohen investime të mirargumentuara, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe me miratim të Këshillit të Ministrave, çmimi i qiradhënies mund të vendoset 1 euro për çdo hektar.

9. Pas shqyrtimit të ofertave, BQTBP-ja tërhiqet për të marrë vendim pa pjesëmarrjen e konkurruesve. Vendimi u komunikohet pjesëmarrësve në ankand brenda 5 ditëve punë. Vendimet e BQTBP-së janë të vlefshme, kur për to votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

10. Kur edhe pas njoftimit, sipas pikës 3 të këtij kreu, nuk paraqitet ofertë tjetër, sekretari i komunës dhe/ose bashkisë ia paraqet kërkesën e vetme për marrjen me qira, BQTBP-së, e cila e shqyrton brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

Vendimi i komunikohet personit, fizik ose juridik, që ka ushtruar kërkesën.

11. Ndërmjet komunës dhe/ose bashkisë, që përfaqësohet nga kryetari, dhe fituesit të ankandit ose kërkuesit për marrjen me qira të tokës bujqësore nënshkruhet kontrata tip, përmbajtja dhe forma e së cilës miratohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Në rast se personi i shpallur fitues nga BQTBP-ja refuzon lidhjen e kontratës, ftohet, për lidhjen e kontratës, fituesi i vendit të dytë, të tretë e kështu me radhë.

Kontrata regjistrohet kundrejt tarifës së përcaktuar në vendimin nr.549, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave, në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP).

12. Afatet e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara, janë:

- Deri në 10 vjet, për kontratat afatshkurtra, për veprimtari, që përfshijnë kultivimin e bimëve të arave;

- Deri në 30 vjet, për kontratat afatmesme, për ndërtimin e fidanishteve, serrave, të prodhimeve blegtorale etj;

- Deri në 99 vjet, për kontratat afatgjata, për veprimtari, si ndërtimi i pemëtoreve, vreshtave dhe ullishtave.

Sipërfaqja e dhënë me qira nuk mund të jetë më e vogël se 0.1 ha.

13. Konkurruesit në ankand kanë të drejtë ankimimi ndaj vendimit të BQTBP-së te Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, brenda 5 ditëve nga dalja e vendimit. Shqyrtimi i ankesës bëhet brenda 10 ditëve. Akti i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është përfundimtar.

14. Dokumentacioni i dhënies me qira të tokës bujqësore, të pandarë, ruhet përgjithmonë pranë komunës dhe/ose bashkisë, ndërsa një kopje depozitohet në ZVRPP.

15. Të ardhurat financiare, që sigurohen nga dhënia me qira e tokës bujqësore, të pandarë, i kalojnë buxhetit të komunës dhe/ose bashkisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.8, datë 5.6.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 30.1.2006 “PËR TATIMIN
MBI VLERËN E SHTUAR”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.3, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1.1 “Detyrimi për të kërkuar regjistrimin”, paragrafi i parë shfuqizohet dhe zëvendësohet me paragrafin e formuluar si më poshtë:

“ Çdo person fizik apo juridik që zhvillon veprimtari ekonomike, qarkullimi i të cilit tejkalon apo parashikohet të tejkalojë 8 milionë lekë për një vit kalendarik, ose do të kryejë veprimtari në fushën e importit, detyrohet të kërkojë të regjistrohet.”.

2. Pika 7.9.3 “Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së”, shfuqizohet dhe zëvendësohet me pikën 7.9.3 të formuluar si më poshtë:

“7.9.3 Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH.

Me ligjin nr.9597, datë 27.7.2006, ndryshohet pika 2.1 e nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht llojit të saj, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për një periudhë deri në gjashtë muaj, sipas së cilës TVSH-ja nuk paguhet në doganë në çastin e importit.

I. Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për importimin e makinerive e të pajisjeve.

Kjo skemë zbatohet për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi vlerën e shtuar. Kusht është që importi i kryer të jetë në funksion të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm dhe nuk kushtëzohet nga lloji i saj.

Përsa i përket kuptimit të termave, jepen përcaktimet e mëposhtme:

- “Makinë”, çdo konstruksion, i krijuar prej njeriut, që, duke marrë energji në një formë të përshtatshme dhe udhëzimet e duhura, është në gjendje të kryejë punë.

- “Linjë teknologjike”, tërësia e makinerive, pajisjeve dhe instalimeve të ndryshme, të lidhura ndërmjet tyre, që bëjnë të mundur realizimin e një procesi teknologjik.

- “Proces teknologjik”, tërësia e metodave, që duhen të ndiqen, hap pas hapi, për të bërë të mundur arritjen e qëllimit, për të cilin bëhet investimi përkatës.

- “Pajisje”, pajisjet dhe aparaturat, që shërbejnë si plotësuese të makinerive dhe që ndihmojnë për funksionimin e rregullt të tyre, si dhe për matjen dhe kontrollin e parametrave të punës.

1.1 Kushte të përgjithshme

Pagesa e TVSH-së shtyhet deri në gjashtë muaj nga çasti i kryerjes së importit.

Ky afat mund të jetë më i shkurtër, kur:

- nga vetë personi i tatueshëm, kërkohet të bëhet pagesa në një çast më të hershëm se mbarimi i periudhës gjashtëmujore;

- personat e tatueshëm importojnë makineri me qëllim shitjen e tyre te persona të tretë. Pagesa e TVSH-së nga këta persona shtyhet deri në periudhën tatimore (muajin) në të cilën bëhet edhe shitja e makinerive.

Personi i tatueshëm, përfitues i kësaj skeme, paraqet në organin doganor dokumentacionin e nevojshëm justifikues, shoqërues të makinerive e pajisjeve të importuara, bazuar në kërkesat e legjislacionit doganor.

Vlera e tatueshme e makinerive dhe e pajisjeve të importuara përcaktohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit, doganor dhe tatimor, pavarësisht nëse makineritë e pajisjet e importuara janë apo jo të taksueshme me taksa doganore. Kjo vlerë përfshin, gjithashtu:

a) shpenzimet e transportit e të sigurimit dhe shpenzimet e tjera, të përfshira në importimin e makinerive e të pajisjeve, deri në çastin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) tarifat, taksat dhe detyrimet e pagueshme, si pasojë e eksportimit të këtyre makinerive e

pajisjeve nga shtete, prej të cilave ato eksportohen, apo të pagueshme si rezultat i importimit të tyre, përveç TVSH-së së pagueshme.

Organi doganor, pasi përcakton vlerën e tatueshme të makinerive dhe të pajisjeve, me të gjitha elementet përbërëse të saj, zbaton mbi këtë vlerë shkallën tatimore të TVSH-së, e cila është në fuqi në çastin e importimit të makinerive e pajisjeve.

TVSH-ja e llogaritur nga organi doganor nuk paguhet nga personi i tatueshëm në çastin e zhdoganimit të makinerive e pajisjeve të importuara; ajo paguhet nga personi i tatueshëm importues, brenda gjashtë muajve nga çasti i importimit të makinerive dhe pajisjeve. Pagesa e saj bëhet për llogari të degës doganore, ku janë kryer procedurat e importit.

1.2 Personat e tatueshëm importues

a) persona që importojnë makineri e pajisje, për investim për veprimtarinë e tyre

Në çastin e importit të makinerive e pajisjeve për t'u investuar, personit të tatueshëm që importon për të investuar, i lëshohet deklarata doganore (DAV) e importit (IM4) me një numër regjistrimi R. Në kutinë nr.37 të DAV-it, është vendosur kodi shtesë 991 për (shtyrjen e pagesës së TVSH-së për makineri e pajisje).

Në kutinë nr.47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-it, kolona MP, në zërin TVSH shënohet 2, që nënkupton mospagimin e TVSH-së në çastin e importimit. Kështu në totalin e detyrimeve që duhen paguar paraqitet vetëm shuma e detyrimeve doganore.

Në momentin e pagesës së TVSH-së printohet DAV-i, versioni i fundit i deklarates, e cila ka të njëjtin numër regjistrimi R dhe në kutinë 37 do të jetë kodi shtesë 003 për (pagesën e TVSH-së për makineri e pajisje për investime).

Në kutinë nr.47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-it, kolona MP, në zërin TVSH shënohet 1, që nënkupton pagimin e TVSH-së.

Ky dokument, versioni i fundit, është edhe dokumenti justifikues i importit i vlefshëm për regjistrimet e mëtejshme për efekt të TVSH-së.

Data e pagesës së TVSH-së në doganë, e paraqitur në dokumentin justifikues që përmendëm, përcakton edhe periudhën tatimore (muajin), në të cilën pesoni i tatueshëm e regjistron (vetëm për qëllim të mbajtjes së dokumentacionit për TVSH) dhe deklaron TVSH-në si të zbritshme pranë organeve tatimore.

Regjistrimi në librin e blerjeve të TVSH-së, i vlerës së makinerive e pajisjeve, si dhe TVSH-së së zbatuar në import, bëhet në periudhën tatimore (muajin), që është paguar TVSH-ja në import.

Për çdo regjistrim vendoset dukshëm, në çastin e kryerjes së importit, shënimi "Import me shtyrje pagese të TVSH-së, referuar deklarates doganore nr.____/datë_____".

Në formularin e deklarimit dhe të pagesës së TVSH-së, të kësaj periudhe tatimore, vlera e tatueshme e makinerive dhe e pajisjeve dhe TVSH-ja, e llogaritur dhe e paguar për importin e tyre, raportohen përkatësisht në rubrikat e importit (14) dhe (15).

b) Personat e tatueshëm, që importojnë makineri për t'i shitur

Këta persona nuk paguajnë TVSH në doganë për makineritë e përcaktuara në aneksin, që i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559, datë 16.8.2006.

Personat e tatueshëm, që importojnë makineri për furnizimin e personave të tretë, kanë të drejtë të përfitojnë nga skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në periudhën tatimore (muajin), në të cilin bëjnë shitjen e tyre, por jo më vonë se gjashtë muaj nga çasti i importimit.

Në çastin e importit të makinerive, personit të tatueshëm i lëshohet deklarata doganore (DAV) e importit (IM4) me një numër regjistrimi R. Në kutinë nr.37 të DAV-it është vendosur kodi shtesë 992 për (shtyrjen e pagesës së TVSH-së së makinerive për shitje).

Në kutinë nr.47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-it, kolona MP, në zërin TVSH shënohet 2, që nënkupton mospagimin e TVSH-së në çastin e importimit. Kështu në totalin e detyrimeve që duhen paguar paraqitet vetëm shuma e detyrimeve doganore.

Në të njëjtën periudhë tatimore (muaj) kur personi i tatueshëm shet makineritë e importuara, detyrohet të paguajë TVSH-në, për importin e tyre, në degën e doganës ku është bërë importi.

Në momentin e pagesës së TVSH-së printohet DAV-i, versioni i fundit i deklarates e cila ka të njëjtin numër regjistrimi R dhe në kutinë 37 do të jetë kodi shtesë 004 për (pagesën e TVSH-së për makineri për t'u shitur).

Në kutinë nr.47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-it, kolona Mp, në zërin TVSH shënohet 1, që nënkupton pagimin e TVSH-së.

Ky dokument, versioni i fundit, është edhe dokumenti justifikues i importit i vlefshëm për regjistrimet e mëtejshme për efekt të TVSH-së.

Data e pagesës së TVSH-së në doganë, e paraqitur në dokumentin justifikues që përmendëm, përcakton edhe periudhën tatimore (muajin), në të cilën personi i tatueshëm e regjistron (vetëm për qëllim të mbajtjes së dokumentacionit për TVSH) dhe deklaron TVSH-në si të zbritshme pranë organeve tatimore.

Regjistrimi në librin e blerjeve të TVSH-së, i vlerës së makinerive e pajisjeve, si dhe TVSH-së së zbatuar në import, bëhet në periudhën tatimore (muajin), që është paguar TVSH-ja në import.

Për çdo regjistrim vendoset dukshëm, në çastin e kryerjes së importit, shënimi “Import me shtyrje pagese të TVSH-së, referuar deklaratës doganore nr.____/datë_____”.

Në formularin e deklarimit dhe të pagesës së TVSH-së, të kësaj periudhe tatimore, vlera e tatueshme e makinerive dhe TVSH-ja, e llogaritur dhe e paguar për importin e tyre, raportohen përkatësisht në rubrikat e importit (14) dhe (15).

c) Personat që importojnë pajisje me qëllim për t'i shitur

Për importin e pajisjeve me qëllim shitjeje nuk zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së.

Në çastin e importit të pajisjeve, bëhet edhe pagesa e TVSH-së në doganë lidhur me këtë import.

Regjistrimet e mëtejshme bëhen njëloj si ato të importeve të zakonshme të mallrave.

II. Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për importimin e energjisë elektrike nga KESH.

Për importimin e energjisë elektrike nga KESH-i, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës të TVSH-së, sipas të cilës KESH sha-së i lejohet shtyrja e pagesës së TVSH-së mbi importin e energjisë elektrike deri në çastin e dorëzimit të deklaratës përkatëse të TVSH-së, duke mos paguar TVSH-në në doganë në çastin e importit.

Në periudhën tatimore, që i përgjigjet kryerjes së importit të energjisë elektrike, nga KESH, lëshohet menjëherë një faturë tatimore shitjeje me TVSH (brenda vendit), për të njëjtën vlerë me atë të energjisë elektrike të importuar, ku shitësi dhe blerësi janë i njëjti person.

Kjo faturë regjistrohet nga KESH edhe në librin e shitjeve dhe në atë të blerjeve.

Në formularin e deklarimit dhe të pagesës së TVSH-së të së njëjtën periudhë tatimore, vlera e tatueshme e energjisë elektrike të importuar, si dhe e TVSH-së së llogaritur për të, raportohen në kutitë përkatëse të importit; në të njëjtën deklaratë të njëjtat vlera raportohen si shitje brenda vendit dhe TVSH e llogaritur për këto shitje.

KESH-i detyrohet të dorëzojë në degën e tatimeve, ku është regjistruar, brenda datës 14 të muajit pasardhës, së bashku me formularin e deklarimit dhe të pagesës së TVSH-së, edhe dokumentet e mëposhtme, në dy kopje:

- Kopje të faturës së shitjes së hartuar, si më lart shpjeguar;
- Kopje të librit të shitjes dhe të blerjes të periudhës përkatëse tatimore;
- Kopje të deklaratës doganore të importit.

KESH-i detyrohet të dorëzojë në degën e doganës përkatëse, brenda datës 25 të muajit pasardhës, për mbylljen e llogarive kontabël të importit, një kopje të çdo dokumenti të mëposhtëm:

- Kopje të faturës së shitjes së hartuar;
- Kopje të librit të shitjes dhe të blerjes së periudhës përkatëse tatimore;
- Kopje të FDP-së, të gjitha këto të vulosura nga zyra e TVSH-së.

Mosdërgimi i të gjithë dokumentacionit në degën e doganës u jep të drejtë organeve doganore të pezullojnë aplikimin e kësaj skeme.

3. Pika 7.12 “Importuesit e vegjël” shfuqizohet.

4. Paragrafi i dytë i shkronjës a, në pikën 15.2, shfuqizohet dhe zëvendësohet me paragrafin e formularit si më poshtë:

“Me autorizim me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kur gazoili i domosdoshëm për të ushtruar veprimtari ekonomike zë një peshë të konsiderueshme në shpenzimet e bëra nga personi i tatueshëm. Në këtë rast personi i tatueshëm paraqet kërkesë me shkrim në degën përkatëse të tatimeve. Kërkesa shoqërohet me të dhënat e nevojshme për të gjykuar mbi situatën tatimore të personit të tatueshëm, si konsumi mesatar mujori i gazoilit, inventari i makinerive ose mjeteve të transportit, pagesa e taksave për makineritë dhe mjetet e transportit, pagesa e detyrimeve të tjera tatimore (TVSH, tatim mbi fitimin) për vitin në të cilin bëhet kërkesa dhe vitin paraardhës, si dhe

një vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore dhe kontributet nga dega e tatimeve ku personi është regjistruar.

Kërkesa së bashku me dokumentet shoqëruese dërgohet nga personi i tatueshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve brenda 30 ditëve nga data e protokollimit të kërkesës, lëshon ose jo autorizimin për lejimin e kreditimit dhe e dërgon atë zyrtarisht, një kopje në adresë të personit të tatueshëm dhe një kopje degës së tatimeve ku personi i tatueshëm është regjistruar. Autorizimet e lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve evidentohen në një regjistër të veçantë.”.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.756, datë 17.5.2007

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës, nenin 19 pika 2 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenet 27, 29 dhe 31 të ligjit nr.8495, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. T’i delegohet Zëvendësministrit të Mbrojtjes (i ngarkuar për çështjet ekonomike) kompetenca për nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësim gjyqësor dhe të ankimimeve në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë, ku palë e paditur është Ministria e Mbrojtjes.

2. Ky urdhër të dërgohet për botim në Qendrën e Publikimeve Zyrtare nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Ndjek dhe ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Zëvendësministri i Mbrojtjes (i ngarkuar për çështjet ekonomike), Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Harmonizimit të Legjislacionit dhe Marrëdhënieve me Kuvendin.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MBROJTJES
Fatmir Mediu

KËRKESË PËR KOMPENSIM

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.257, datë 11.4.2007 “Për kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuara në disa raste të veçanta” janë paraqitur dy kërkesa në ZRKKP të qarkut Tiranë.

Kërkesat janë nga Z.Bardhyl Pelingu dhe trashëgimtarët e z.Refik Toptani.

Trojet e kërkuara në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.257, datë 11.4.2007 dhe për publikim janë:

1.Tri parcela me sipërfaqe respektive:

- $S_1 = 26 \text{ m}^2$

- $S_2 = 86 \text{ m}^2$

- $S_3 = 980 \text{ m}^2$

Të ndodhura në rrugën “Sami Frashëri”, në sipërfaqen që ka shërbyer si shesh i modelimit të hidrocentraleve në Laboratorin e Hidraulikës. Këto parcela ndodhen ndërmjet pronave të familjeve Pelingu, Toska dhe Alla. Kjo pronë ka numër pasurie 7/92 dhe sipas ZVRPP Tiranë figuron “shtet”.


2. Një parcelë me sipërfaqe $S=392.4 \text{ m}^2$, e ndodhur në kryqëzimin e rrugës “Elbasanit” dhe “Myslym Shyri”


Bashkëlidhur, dy gentplanet përkatëse.

Për zbatimin e shkronjës “a” të pikës 5 të vendimit, i përcjellim në Ministrinë e Drejtësisë këto

kërkesa për botim në Fletoren Zyrtare.

DREJTORE E PËRGJITHSHME
Justina Boriçi





Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 6.6.2007
Doli nga shtypi më 8.6.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë